



DHUNA NDAJ GRAVE NË POLITIKË



Ky raport studimor është porositur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shqipëri dhe është realizuar në partneritet me Avokatin e Popullit (AP) dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport studimor nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), AP-së, KMD-së apo të Qeverisë së Suedisë.

Autore: Marsela Dauti, PhD dhe Geldona Metaj, MSW

Falenderojmë pjesëmarrëset/it në studim që ndanë njohuritë dhe përvojat e tyre rreth dhunës politike. Mirënjohje e veçantë shkon për Rrjetin e Grave Barazi në Vendimmarrje për mbështetjen gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave.



Tiranë, Shqipëri
Nëntor 2021

GJETJET DHE SUGJERIMET KRYESORE

Komponenti cilësor (ndarja e historive dhe diskutimet në grup)

- Gratë ndanë histori ku vinin në pah se janë përçmuar, janë ofenduar, ju është ndërprerë fjala, janë tallur, janë fyer, kanë rënë pre e batutave dhe akuzave të rreme në media, si dhe janë kërcënuar. Praktika të tjera përjashtuese dhe diskriminuese përfshinin vënien në dyshim të aftësive të grave, heqjen e grave nga listat e kandidatëve të partisë, refuzimin e aksesit në financat e partisë gjatë fushatave zgjedhore, shkarkimin ose kërcënimin për shkarkimin e grave (dhe anëtarëve të familjes së tyre) nga postet shtetërore, ngritjen e akuzave të rreme dhe thashetheme të natyrës seksuale, injorimin e grave gjatë takimeve, konsiderimin e kontributit të grave si pak ose aspak të rëndësishëm, kufizimin e rolit të grave në votimin e vendimeve të paracaktuara, manipulimin e votës së grave gjatë procedurave të votimit dhe përjashtimin e tyre nga informacioni.
- Autorët e dhunës kërkonin që të ruanin ose zgjeronin përfitimet e lidhura me postet politike, të tilla si vendet e punës, të ardhurat, pasuritë dhe qasjen në rrjete. Duke vënë në dyshim aftësitë dhe kapacitetet e grave, si dhe synimet e tyre në politikë, autorët nxitën ndasi gjinore dhe kërkonin që të ndiknin te votuesit. Praktika të tjera, si p.sh. kufizimi i rolit të grave për të votuar vendime të paracaktuara, janë përdorur për t'i kontrolluar gratë dhe për t'i bërë ato të padukshme në politikë.
- Për gratë – veçanërisht gratë të cilat janë përpjekur të arrijnë pozicione drejtuese në parti – partia ku ato aderojnë është burimi kryesor i dhunës. Gratë e cilësuan dhunën me të cilën janë përballur në partinë e tyre si “të fshehtë, të ndërlikuar dhe



të vështirë për t'u trajtuar.” Gjatë ndarjes së eksperiencave gratë u shprehën se drejtuesit e partive zgjedhin të preferuarit e tyre – persona që nuk janë gjithmonë të kualifikuar ose të cilët nuk kanë lidhje të forta me bazën – injorojnë opinionet e anëtarëve të partisë, heqin nga listat e kandidatëve anëtarë të partisë me kontribut afatgjatë, paracaktojnë rezultatet zgjedhore, shpërndajnë burimet në mënyrë të pabarabartë (p.sh. fondet gjatë fushatave zgjedhore), si dhe nuk janë transparentë gjatë vendimmarrjes. Një sistem i centralizuar dhe i padrejtë vendimmarrjeje në partitë politike sjell dhunë, dhe e përdor dhunën si kërcënimet dhe akuzat për të mbijetuar.

- Gratë, veçanërisht ato të angazhuara rishtazi, thanë se për shkak të dhunës psikologjike që kanë përjetuar, ato kanë vënë në pikëpyetje aftësinë dhe vendin e tyre në politikë. Gratë që kanë qenë objekt i akuzave të rreme dhe thashethemeve në media raportuan se këto përvoja kanë përkeqësuar problemet e tyre shëndetësore dhe u kanë shkaktuar probleme me gjumin. Akuzat e rreme dhe thashethemet me natyrë seksuale kanë patur pasoja traumatike për gratë dhe familjet e tyre – fëmijët, prindërit dhe partnerët.
- Trajtimi i dhunës ndaj grave në politikë kërkon që para së gjithash partitë të demokratizohen. Nëse partitë demokratizohen, gratë do të përjetojnë më pak dhunë psikologjike. Përgjithësisht, klima politike do të jetë më pak agresive.

Komponenti sasior (të dhënat e anketës)

- *Një përqindje më e lartë e kandidatëve politikë thanë se gjuha poshtëruese dhe lajmet e rreme (55,56%) janë pjesë normale e politikës, pasuar nga frikësimi dhe dhuna (42,16%), kërcënimi (30,16%), dëmtimi i pronës (16,34%) dhe dhuna fizike (6,86%).*
- 31,05% e të anketuarve (n = 95) raportuan se kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme në rolin e tyre si politikan/e. Kandidatët politikë ishin shënjestruar kryesisht nga mbështetësit e partive të tjera (57,45%), nga media digjitale dhe sociale (50%) dhe drejtuesit e partive të tjera (44,68%). Gjuha poshtëruese ose lajmet e rreme shënjestronin kryesisht gjininë (23,40%), moshën (21,28%), statusin social (21,28%) dhe statusin ekonomik (17,02%).*

- Përqindja e grave që thanë se gjuha *poshtëruese ose lajmet e rreme me të cilat ish in përballur kishin natyrë seksuale, ishte më e lartë në krahasim me burrat.*
- 13,40% e të anketuarve (n = 41) raportuan se kanë marrë *kërcënime* lidhur me rolin e tyre në politikë. Kandidatët politikë ish in shënjestruar kryesisht nga drejtuesit e partive të tjera (60,98%) dhe nga mbështetësit e partive të tjera (58,54%).
- 10,16% e të anketuarve (n = 31) u shprehën se kanë përjetuar *dëmtim të pronës gjatë përfshirjes së tyre në politikë.*
- 18,52% e të anketuarve (n = 55) thanë se atyre u është mohuar mbështetje financiare nga partia, 12,79% (n = 39) thanë se kanë marrë kërcënime për shkarkim nga puna për shkak të përfshirjes në politikë dhe 6,89% (n = 21) thanë se kanë marrë kërcënime nga anëtarët e familjes – kërcënime për shkëputjen nga burimet ekonomike apo pronat – për shkak të përfshirjes në politikë.
- 12,42% e të anketuarve (n = 38) thanë se njerëzit e tyre të afërt kanë përjetuar dhunë për shkak të rolit të tyre në politikë. Viktima të dhunës ish in kryesisht anëtarët e familjes, miqtë dhe njerëzit që punojnë për kandidatët politikë.
- 58 kandidatë politikë – 18,95% e të anketuarve ose 57,42% e personave që ish in përballur me dhunë – thanë se i kishin ndarë përvojat e tyre me partinë. Strukturat kryesore të partisë, me të cilat kandidatët politikë i ndanin përvojat e tyre ish in drejtuesit e partive (68,42%) dhe koordinatorët politikë (52,63%). Arsyet përse kandidatët politikë nuk e ndanin përvojën e tyre me strukturat e partisë ish in se ata nuk mendonin që strukturat në fjalë do të reagonin, ata e konsideronin dhunën si diçka personale ose nuk e konsideronin përvojën e tyre si mjaftueshëm shqetësuese.
- 36,84% e personave që ndanë përvojat e tyre me strukturat e partisë thanë se këto të fundit morën masa. Masa kryesore ishte dhënia e një deklarate shtypi dhe denoncimi i dhunës.
- 57,14% e të anketuarve që ish in përballur me dhunë thanë se e kishin ndarë përvojën e tyre me aktorë të tjerë, krahas strukturave të partisë. Kandidatët politikë i ndanin përvojat e tyre kryesisht me familjen (80,70%) dhe me miqtë (78,95%). Një numër i vogël i të

anketuarve thanë se kishin informuar Policinë e Shtetit (n = 5), Avokatin e Popullit (n = 1) dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (n = 2).

- Kandidatët politikë sugjeruan krijimin e mekanizmave dhe instrumenteve ligjore që ndëshkojnë autorët e dhunës. Sugjerimet e tjera përfshinin mospërfshirjen e administratës shtetërore në zgjedhje, depolitizimin e Policisë së Shtetit, organizimin e fushatave informuese për dhunën politike, dhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të Avokatit të Popullit gjatë fushatave zgjedhore – për të identifikuar dhe denoncuar rastet e dhunës politike.



TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|-----------|
| Hyrje | 10 |
| Metodologjia | 13 |
| Ndarja e historive | 13 |
| Diskutime në grup | 14 |
| Anketa me kandidatët politikë | 16 |
| | |
| Gjetjet: Komponenti cilësor | 18 |
| Gratë tregojnë historitë e tyre (ndarja e historive) | 18 |
| Format e dhunës politike | 18 |
| Arsyet e dhunës politike | 28 |
| Ndikimi i dhunës politike | 29 |
| Perspektiva të tjera lidhur me dhunën ndaj grave në politikë (diskutime në grup).. | 31 |
| | |
| Gjetjet: Komponenti sasior | 33 |
| Klima politike | 34 |
| Përvoja gjatë fushatës zgjedhore dhe mandateve parlamentare | 37 |
| Trajtimi i dhunës | 45 |
| Ndikimi i angazhimit në politikë | 48 |
| | |
| Sugjerime | 48 |
| | |
| Referenca | 51 |
| | |
| Shtojca A: Karakteristikat e pjesëmarrësve në studim (komponenti cilësor) | 53 |
| | |
| Shtojca B: Rezultatet e anketës (komponenti sasior) | 56 |

LISTA E FIGURAVE

| | |
|---|----|
| Figura 1: “Dhuna është pjesë normale e politikës” | 34 |
| Figura 2: A do të thonit se frikësimi dhe dhuna janë pjesë normale e politikës në vend? | 35 |
| Figura 3: A janë gjuha poshtëruese dhe lajmet e rreme rreth politikanëve një pjesë normale e politikës në vend? | 35 |
| Figura 4: A janë kërcënimet ndaj politikanëve një pjesë normale e politikës në vend?..... | 36 |
| Figura 5: A është dhuna fizike ndaj politikanëve një pjesë normale e politikës në vend? | 36 |
| Figura 6: A është dëmtimi i pronës – personale ose të partisë – një pjesë normale e politikës në vend? | 37 |
| Figura 7: A keni përjetuar gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme në rolin tuaj si politikan/e?..... | 37 |
| Figura 8: Sa shpesh keni përjetuar gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme?..... | 38 |
| Figura 9: A keni përjetuar kërcënime në lidhje me pozicionin tuaj në politikë? | 39 |
| Figura 10: Sa shpesh keni përjetuar kërcënime? | 40 |
| Figura 11: A keni përjetuar kërcënim ose ngacmim në mënyrë të vazhdueshme nga i njëjti person?..... | 41 |
| Figura 12: A keni përjetuar dhunë fizike në lidhje me rolin tuaj në politikë? | 41 |
| Figura 13: A ju është dëmtuar prona gjatë përfshirjes tuaj në politikë?..... | 42 |
| Figura 14: Sa shpesh ju është dëmtuar prona? | 43 |
| Figura 15: Llojet e tjera të dhunës të përjetuara nga kandidatët politikë | 44 |
| Figura 16: A ka përjetuar dhunë ndonjë nga personat që janë të afërt me ju për shkak të rolit tuaj politik? | 44 |
| Figura 17: Sa herë mendoni se personat që janë të afërt me ju kanë përjetuar dhunë politike? | 45 |
| Figura 18: A ka partia juaj një Kod të Sjelljes apo instrumente të tjera që parashikojnë dhunën ndaj grave ose dhunën me bazë gjinore? | 46 |
| Figura 19: A ka partia juaj mekanizma apo struktura të dedikuara që janë ngritur për të parandaluar dhe trajtuar çdo rast të dhunës me bazë gjinore, duke vënë në fokus të viktimit?..... | 46 |

HYRJE

Dhuna ndaj grave në politikë përbën shkelje të drejtave të njeriut dhe përforcon marginalizimin e grave në politikë (Bardall et al., 2020; Këshilli i Evropës, 2011). E përkufizuar si “çdo lloj dhune që pengon zhvillimin e rregullt të proceseve politike” (Bardall et al., 2020, f. 917), dhuna në politikë është një fenomen botëror. Dhuna ekziston në një cikël të vazhdueshëm dhe format e ndryshme të saj – fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike – ndërveprojnë me njëra-tjetrën (Krook, 2020). Pjesa më e madhe e studimeve lidhur me dhunën politike fokusohet në dhunën fizike, duke rezultuar në “anshmëri ndaj akteve të dukshme të dhunës fizike që ndodhin në sferën publike” (Bjarnegård, 2018, f. 2). Vetëm në vitet e fundit, studiuesit janë fokusuar në dimensionet gjinore të dhunës në politikë. Studimet tregojnë se gratë politikane, në raport me burrat politikanë, kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë të padukshme (Bjarnegård, 2018), të përballen me dhunën pas dyerve të mbyllura (Krook, 2020), si dhe të bëhen shënjestër e dhunës psikologjike (Bardall et al., 2020). Studime të tjera tregojnë se gratë kanë më shumë gjasa se burrat që të jenë objekt i kërcënimeve dhe akuzave me natyrë seksuale (Bjarnegård et al., 2020). Autorët e dhunës shënjestrojnë në veçanti gratë të cilat mbajnë pozicione të rëndësishme në politikë dhe janë të pranishme në media (Håkansson, 2021).

Për dhunën ndaj grave politikane në Shqipëri janë kryer vetëm një numër i vogël studimesh (Anastasi, 2020; Instituti Demokratik Kombëtar, 2021; Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në proces botimi). Studimet tregojnë se niveli i ndërgjegjësimit është i ulët për sa i përket asaj çka përbën dhunë ndaj grave në politikë (Instituti Demokratik Kombëtar, 2021) dhe bëjnë thirrje për ndryshime të Kodit Zgjedhor, ligjit «Për barazinë gjinore», Kodit Penal, ligjit «Për partitë politike», ligjit «Për mbrojtjen nga diskriminimi» dhe ligjit «Për nëpunësin civil» (Anastasi, 2020). Kodi i Sjelljes – i përgatitur përmes përpjekjeve të përbashkëta përpara zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021 – mund t’i udhëzojë partitë politike gjatë fushatave zgjedhore (shih Kodi i Sjelljes, 2021).¹ Komuniteti ndërkombëtar e ka përkrahur pjesëmarrjen e lartë të

grave në politikë përmes reformave të politikave, si p.sh. kuotat gjinore në listat zgjedhore (Dauti, 2020). Megjithatë, miratimi dhe zbatimi i reformave për barazinë gjinore është i pamjaftueshëm. Për të garantuar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e plotë në politikë, është e rëndësishme që vëmendja të përqendrohet në atë çfarë ndodh pasi gratë bëhen pjesë e hapësirave politike, veçanërisht pengesat me të cilat ato përballen. UNDP po e mbështet qeverinë e Shqipërisë që të përmbushë rekomandimet e GREVIO-s – organi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. UNDP po punon ngushtë me institucione të pavarura, duke përfshirë Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të forcuar rolin e tyre si organe mbikëqyrëse të Konventës. UNDP ka organizuar takime konsultuese me grupe të ndryshme interesi (p.sh. institucione të pavarura që monitorojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, organizata të shoqërisë civile, avokatë, studiues dhe ofrues shërbimesh) për të hartuar një ligj që trajton dhunën ndaj grave dhe vajzave. Një pjesë e këtyre përpjekjeve përfshin edhe analizimin e dhunës ndaj grave në politikën shqiptare. Çfarë dëshmojnë historitë e grave rreth përvojave të tyre të dhunës politike? Cilat janë llojet, motivet dhe ndikimet e dhunës politike? A ka dallime midis grave dhe burrave për sa u përket llojeve të dhunës me të cilën ata përballen? Ky raport studimor do t'ju trajtojë këto pyetje duke përdorur tri metoda të grumbullimit të të dhënave – ndarjen e historive, diskutimet në grup dhe një anketë me kandidatët politikë. Në disa pjesë të raportit, i referohemi përvojave të grave dhe të burrave. Krahasimi na ndihmon që të kuptojmë nëse autorët e dhunës i shënjestrojnë gratë në cilësinë e politikanes apo të gruas (Bjarnegård et al., 2020). Qëllimi i raportit studimor është që të shqyrtojë dhunën ndaj grave në politikë dhe të hedhë dritë lidhur me çfarë mendojnë aktorë të ndryshëm se duhet bërë për të trajtuar dhunën.² Përfundimet e studimit mund të përdoren nga aktorët lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të trajtuar dhunën ndaj grave në politikë dhe, më gjerë, për të krijuar një mjedis të sigurt në politikë. Në të ardhmen, institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut dhe organizatat e

shoqërisë civile në Shqipëri mund të monitorojnë dhunën ndaj grave në politikë dhe t'i përdorin rezultatet për të formësuar opinionin publik dhe reformat për barazinë gjinore.

Pjesa tjetër e raportit studimor ndahet si në vijim: seksioni 2 përshkruan metodologjinë – modelin kërkimor, metodat dhe analizën e studimit; seksioni 3 paraqet gjetjet bazuar tek tri metodat e grumbullimit të të dhënave – ndarjen e historive, diskutimet në grup dhe anketës me kandidatët politikë; seksioni 4 paraqet sugjerimet e dhëna nga pjesëmarrësit në studim, duke përfshirë gratë e angazhuara në politikë, kandidatët politikë, gazetarët, Rrjetin “Barazi në Vendimmarrje”, organizatat e shoqërisë civile, forumet rinore, Aleancën e Grave Këshilltare dhe gratë që drejtojnë njësitë administrative.

“Dhuna fizike përfshin lëndimet dhe dëmtimet trupore, por mund të përfshijë edhe lloje të ndryshme të kontaktit fizik të padëshiruar, si dhe izolimin fizik të pavullneshëm. Dhuna psikologjike shkakton traumë në gjendjen mendore ose mirëqenien emocionale të një personi, për shembull, përmes kërcënimeve për vdekje ose përdhunim, ose fyerjeve, talljeve apo trembjeve të personit të synuar. Dhuna seksuale përfshin aktet seksuale dhe përpjekjet për kryerjen e akteve seksuale duke përdorur forcën, si dhe komentet ose gjestet e padëshiruara seksuale. Dhuna ekonomike përfshin sjelljet që kanë për qëllim mohimin, kufizimin ose kontrollin e aksesit të grave në burimet financiare” (Krook, 2020, fq. 122).

METODOLOGJIA

Studimi bazohet në tri metoda të grumbullimit të të dhënave: ndarjen e historive, diskutimet në grup, dhe një anketë me kandidatët politikë.

NDARJA E HISTORIVE

Qëllimi i ndarjes së historive ishte i trefishtë: së pari, për t'u dhënë grave hapësirën që të ndajnë histori me rëndësi për to, së dyti, për të kuptuar përvojat e grave nga pikëpamja e tyre; dhe së treti, për të treguar përvoja që deri më sot kishin mbetur në hije.

Ne i ftuam gratë që të ndanin historitë e tyre të dhunës politike. Ne përdorëm kampionimin e qëllimshëm për të përzgjedhur një grup heterogjen të grave – deputete, anëtare këshilli, kryetare bashkie dhe anëtare partie – si dhe i kushtuam rëndësi karakteristikave të tilla si mosha, përvoja në politikë, përkatësia etnike dhe aftësia e kufizuar. Dërguam ftesa përmes emailit, ku prezantuam qëllimin dhe rëndësinë e studimit dhe diskutuam çështjet e konfidencialitetit. Nga 112 emaile që u dërguan (pjesa më e madhe e emaileve u pasua nga telefonatat), morëm 30 përgjigje. Nga 30 gratë që iu përgjigjën ftesës sonë, 20 ishin të gatshme për intervistë (përqindja përfundimtare e pjesëmarrjes: 17,86%). Në disa raste, gratë ishin të shqetësuara lidhur me ndarjen e historive të tyre ose thanë që nuk kanë përjetuar dhunë.

Ndarja e historive u bazua në pyetjet e mëposhtme:

- 1) A mund të ndani me ne trajektoren tuaj në politikë? Si u përfshitë në politikë dhe çfarë aspironi të arrini në karrierën tuaj politike?
- 2) [Pas përkufizimit të dhunës politike] A mund të ndani me ne një përvojë? Na jepni detaje lidhur me rastin në fjalë.
 - a. Çfarë ndodhi?
 - b. Kur ndodhi?
 - c. Kush ishin aktorët e përfshirë?

- d. Cilat ishin arsytet e dhunuesit/es?
- e. Si vepruat për adresimin e shqetësimit tuaj?
- f. A keni histori të tjera, të cilat dëshironi t'i ndani me ne?
- g. Çfarë ndikimi pati te ju kjo përvojë?

Shumica e intervistave u kryen virtualisht (14 virtualisht, 3 përmes telefonit dhe 3 ballë për ballë). Kohëzgjatja mesatare e intervistave ishte 31,95 minuta (diapazoni: 13 – 57 minuta). Pesë studentë të diplomuar dhe profesionistë ishin pjesë e procesit të transkriptimit të të dhënave. Shqyrtimi i transkriptimeve u mbështet në analizën tematike.

Karakteristikat e pjesëmarrësve në studim

Gratë që ndanë historitë e tyre u përzgjedhën nga 8 qarqe dhe 16 bashki. Moshë mesatare ishte 46 vjeç (*Devijimi standard (DS) = 7,88; diapazoni: 33 – 57*). Dymbëdhjetë gra kishin përfunduar studimet e nivelit Master, 4 kishin gradën e doktoraturës dhe 3 gra kishin përfunduar studimet e nivelit Bachelor, ndërsa njëra nga gratë ishte me arsim të mesëm. Vlera mesatare e viteve të angazhimit në politikë ishte 13,03 (*DS = 10,93; diapazoni: 1 – 30*); 19 gra kishin kandiduar në zgjedhjet vendore ose parlamentare, 17 kishin ushtruar të paktën një mandat në parlament ose në këshillin bashkiak; 11 ishin anëtare të strukturave drejtuese; 3 kishin hequr dorë nga politika; 2 ishin anëtare të pakicave kombëtare; 6 jetonin në zona rurale dhe 3 ishin me aftësi ndryshe. Shih shtojcën A për më shumë informacione rreth pjesëmarrësve në studim.

DISKUTIME NË GRUP

Qëllimi i diskutimeve në grup ishte krijimi i një ideje të qartë lidhur me pikëpamjet e aktorëve të ndryshëm, veçanërisht për sa i përket masave që duhet të ndërmerren për të trajtuar dhunën ndaj grave në politikë.

U organizuan shtatë diskutime në grup me gazetarë (7 pjesëmarrës; 2 diskutime në grup), anëtare të Rrjetit “Barazi në Vendimmarrje” (8 pjesëmarrëse), anëtarë të organizatave të

shoqërisë civile (7 pjesëmarrës), anëtare dhe kryetare të forumeve rinore (6 pjesëmarrëse), anëtare të Aleancës së Grave Këshilltare (12 pjesëmarrëse), dhe drejtuese gra të njësive administrative (5 pjesëmarrëse). Ne u përpoqëm që të kontaktonim dhe të ftonim përmes emailit dhe telefonatave 183 persona. Nga 183 persona që u ftuan për të marrë pjesë në diskutimet në grup, vetëm 45 pranuan të bëheshin pjesë (përqindja e pjesëmarrjes: 24,59%).

Secili diskutim grup u bazua në pyetjet e mëposhtme:

- 1) [Pas përkufizimit të dhunës politike] A është dhuna ndaj grave në politikë një problem i përhapur në Shqipëri?
- 2) A ka ndërmarrë grupi juaj (p.sh. organizatat e shoqërisë civile, Aleanca, Rrjeti, forumet rinore) ndonjë nismë për të trajtuar dhunën ndaj grave në politikë? A mund të na flisni rreth këtyre nismave?
- 3) Çfarë lloji nismash duhet të ndërmerren për të trajtuar dhunën ndaj grave në politikë, duke nisur nga nisma që mund të marrë grupi juaj?

Kohëzgjatja mesatare e diskutimeve ishte 45,5 minuta (diapazoni: 29 – 68 minuta). Katër studentë dhe profesionistë ishin pjesë e procesit të transkriptimit të të dhënave. Shqyrtimi i transkriptimeve u mbështet në analizën tematike.

Karakteristikat e pjesëmarrësve në studim

Në diskutimet në grup morën pjesë dyzet e pesë persona – 39 gra (86,67%) dhe 6 burra (13,33%). Ata iu bashkuan grupeve nga 7 qarqe dhe 14 bashki. 40 nga 45 pjesëmarrës (88,89%) jetonin në zona urbane. Mosha mesatare ishte 39,04 vjeç ($DS = 11,53$; diapazoni: 21 – 63). Gjashtë pjesëmarrës kishin përfunduar studimet e nivelit Bachelor (13,33%), 37 pjesëmarrës kishin përfunduar studimet e nivelit Master (82,22%) dhe 2 pjesëmarrës (4,45%) kishin gradën e doktoraturës. Pjesëmarrësit kishin formime të ndryshme profesionale: Profesionet e tyre ishin biologë, redaktorë, ekonomistë, gazetarë, juristë, mjekë, politologë, punonjës socialë, administratorë socialë, sociologë, mësues, psikologë. Shih shtojcën A për më shumë informacione rreth pjesëmarrësve në diskutime.

ANKETA ME KANDIDATËT POLITIKË

Qëllimi i kësaj ankete ishte të hidhte dritë mbi llojet, motivet dhe ndikimet e dhunës ndaj politikanëve dhe nëse ka apo jo dallime gjinore. Ky studim u krye me politikanë që kandiduan në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Numri i kandidatëve politikë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 ishte 1841 (732 gra ose 39,76% dhe 1109 burra ose 60,24%) (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2021, shih Shtraza dhe Leskaj, 2021, për një përmbledhje kronologjike të përfaqësimit numerik të grave në vendimmarrjen politike). Ne zgjodhëm rastësisht 500 kandidatë politikë (250 gra dhe 250 burra) nga 6 parti politike/aleanca, duke përfshirë Partinë Socialiste, Aleancën për Ndryshim, Lëvizjen Socialiste për Integrim, Partinë Social-Demokrate, Nismën Thurje dhe Lëvizjen për Ndryshim.

Gjatë muajve gusht – shtator 2021, ne trajnuam një grup prej 32 anketuesish, të cilët fillimisht u përpoqën të kontaktonin me 500 kandidatë politikë. Përqindja e refuzimeve ishte e lartë veçanërisht në qarqet e Tiranës dhe Durrësit. Pas përzgjedhjes rastësore të 500 kandidatëve, ne zëvendësuam 104 kandidatë të përzgjedhur rastësisht. Përqindja e pjesëmarrjes ishte 50,66% (306 nga 604 të anketuar).

Pyetësi ishte i ndarë në 5 pjesë: karakteristikat demografike dhe përvoja në politikë, klima politike, përvoja gjatë fushatës zgjedhore dhe mandateve parlamentare, mënyrat e trajtimit të dhunës dhe ndikimi i angazhimit në politikë. Pyetësi u testua me një grup prej 6 kandidatësh politikë. U krye analiza me një variabël dhe me dy variabla për të përshkruar të dhënat dhe për të nxjerrë informacione mbi dallimet gjinore.

Karakteristikat e pjesëmarrësve në studim

Nga 306 kandidatët politikë që morën pjesë në anketë, 152 ishin gra (49,67%) dhe 154 ishin burra (50,33%). 19,28% e të anketuarve kishin përfunduar studimet e nivelit Bachelor, 66,34% kishin përfunduar studimet e nivelit Master dhe 8,82% kishin gradën e doktoraturës. Një përqindje e vogël kishin vetëm arsim të mesëm, ose një nivel arsimor më të ulët. 41,18% e të anketuarve ishin beqarë, 57,19% ishin të martuar, 1,31% ishin të divorcuar dhe 0,33% ishin të ve.

Përqindja e grave beqare ishte më e lartë se ajo e burrave beqarë. 44,74% e grave dhe 37,66% e burrave ishin beqarë, ndërsa 52,63% e grave dhe 61,69% e burrave ishin të martuar. 43,46% e të anketuarve kishin fëmijë nën moshën 18 vjeç, që jetonin me ta në shtëpi, 32,03% punonin në sektorin publik dhe 52,94% në sektorin privat, 8,50% ishin të papunë dhe 4,90% ishin studentë. Burrat kishin më shumë gjasa se sa gratë që të ishin punonjës të sektorit privat. 61,69% e burrave dhe 44,08% e grave ishin punonjës të sektorit privat dhe 27,27% e burrave dhe 36,84% e grave ishin punonjës të sektorit publik. Mosha mesatare ishte 37,16 vjeç (DS = 11,86) – 35,5 vjeç për gratë (DS = 11,45) dhe 38,79 vjeç për burrat (DS = 12,06). Numri mesatar i viteve në parti ishte 6,30 (DS = 7,86), dhe vlera mesatare e vizibilitetit në mediat sociale dhe digjitale ishte 6,69 (DS = 2,48).

81,05% e të anketuarve kanë kandiduar në njëri nga zgjedhjet parlamentare, 11,76% kanë marrë pjesë në dy zgjedhje parlamentare, 4,90% kanë marrë pjesë në tri zgjedhje parlamentare, dhe 2,29% kanë marrë pjesë në më shumë se tri zgjedhje parlamentare. 88,24% e të anketuarve nuk kanë ushtruar asnjë mandat në parlament, 5,88% kanë ushtruar një mandat, 3,27% kanë ushtruar dy mandate, dhe 1,63% kanë ushtruar tri mandate. Vetëm tri kandidatë politikë (0,98%) kanë ushtruar më shumë se tri mandate. 9,15% e të anketuarve (n = 28; 18 gra dhe 10 burra) u zgjodhën në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Shih shtojcën B për më shumë informacione mbi pjesëmarrësit e anketës.

Puna në terren u zhvillua gjatë periudhës gusht-tetor 2021. Një nga sfidat që hasëm gjatë punës në terren ishte përqindja e lartë e kandidatëve që refuzuan të merrnin pjesë në studim. Ka disa arsye për shkallën e lartë të refuzimit. Gjatë punës në terren, mësuam se disa kandidatë politikë nuk kishin bërë fushatë, ose nuk kishin qenë në Shqipëri gjatë fushatës zgjedhore. Në raste të tilla, kandidatët politikë ishin pa përvojë dhe rrjedhimisht nuk kishin se çfarë të ndanin me ne. Një arsye tjetër është ndjeshmëria e temës. Pavarësisht faktit se ekipi studimor diskutoi lidhur me rëndësinë e konfidencialitetit, disa pjesëmarrës në studim ishin skeptikë dhe ngurruan që të ndanin përvojat e tyre. Edhe kur kandidatët politikë

morën pjesë në studim, ata nuk ndiheshin gjithnjë rehat teksa ndanin përvojat e tyre. Politikanët ishin të shqetësuar se ndarja e përvojave lidhur me dhunën politike do të rezultonte në stigmatizim brenda partisë dhe përjashtim nga partia, dhe se do të njollosej reputacioni i tyre në komunitet. Në disa raste, politikanët kishin bindjen se “vetëm personat e varfër dhe më pak të arsimuar janë ata që përjetojnë dhunë.” Për këto arsye, ne mendojmë se kandidatët politikë kanë nënraportuar përvojat e tyre lidhur me dhunën politike, gjë që e bëri më të vështirë identifikimin e hendeikut gjinor nga pikëpamja statistikore.

GJETJET: KOMPONENTI CILËSOR

GRATË TREGOJNË HISTORITË E TYRE (NDARJA E HISTORIVE)

FORMAT E DHUNËS POLITIKE

Historitë e grave dëshmuar një sërë praktikash të cilat përforcojnë dhe nxisin marginalizimin e tyre në politikë. Këto praktika përfshinin: përçmim dhe gjuhë ofenduese; ndërprerje të fjalës, tallje, fyerje, batuta; akuzat të rreme në media; kërcënime; vënien në dyshim të aftësive të grave; heqjen e grave nga listat e kandidatëve të partisë; refuzimin e aksesit në financat e partisë gjatë fushatave zgjedhore; shkarkimin ose kërcënimin për shkarkimin e grave (dhe anëtarëve të familjes së tyre) nga postet shtetërore; akuzat e rreme dhe thashethemet të natyrës seksuale; ngacmimin seksual. Praktikrat e tjera përfshinin injorimin e grave gjatë takimeve; konsiderimin e kontributit të grave si pak ose aspak të rëndësishëm; kufizimin e rolit të grave në votimin e vendimeve të paracaktuara; manipulimin e votës së grave gjatë procedurave të votimit; përjashtimin e grave nga informacioni. Më poshtë do të ndajmë historitë e grave. Emrat e grave janë fiktivë. Kemi përdorur pseudonime përgjatë të gjithë tekstit.

Përçmimi dhe gjuha ofenduese

Blerta, një këshilltare, tha se kryetari i këshillit e kishte quajtur atë “sekretare.” “E kupton?” pyeti ajo. “Ai tha që unë jam askushi.”

Gjatë takimeve të këshillit, kryetari i këshillit e nënvleftësonte atë duke i thënë: “Rritu, sepse nuk di asgjë akoma,” “Ulu,” “Paske gojë të flasësh, ë? Nuk e dija.” Blerta na tregoi se gjatë fushatës së fundit derë më derë, atë e kishin quajtur “ku*vë”³: “Shihni, shihni, po kalon kjo ku*va e partisë [emri i partisë është fshirë].” Ajo raportoi një incident, në të cilin një nga banorët e kapi nga krahu dhe i tha të shporret. Ajo përfundoi me krah të nxirë. Anëtarët e nevrkosur të komunitetit, morën shkopinj dhe i thanë asaj dhe ekipit zgjedhor që e shoqëronte që “të zhdukeshin.”

Ndërprerja e fjalës, talljet, fyerjet, batutat

Valmira drejtoi tri fushata zgjedhore në komunitetin e saj. Kryetari i këshillit dhe kryetari i bashkisë e ndërprejnë gjatë fjalës së saj. Disa nga kolegët e saj burra e shkurajuan që të mos merrte fjalën. Valmira e përshkroi përvojën e saj si më poshtë: “Kur merr fjalën për të diskutuar një çështje për komunitetin që përfaqëson, ka kolegë që thonë: “Po ç’punë ke ti?” I thonë: “Ç’punë ke ti, lëre komunitetin në punën e vet”... Kjo gjë është goxha e dhimbshme pasi unë nuk po flas për vete.” Kur Valmira mori fjalën për të diskutuar lidhur me sistemin e kanalizimeve në komunitetin e saj dhe për mungesën e investimeve, kryetari i bashkisë bëri këtë vërejtje: “Nga e di ti se çfarë po bëjmë ne [d.m.th., çfarë investimesh ka bërë bashkia]?” Valmira u ndje e ofenduar dhe i shpjegoi kryetarit të bashkisë që ajo po fliste për komunitetin në të cilin jeton. Në vijim, kryetari i bashkisë i drejtohej asaj në mënyrë ironike si “ajo që na flet për sistemin e kanalizimeve.”

Gjuha ofenduese kishte veçanërisht në objektiv gratë e angazhuara rishtazi në politikë. Gratë e angazhuara rishtazi treguan se janë etiketuar si “gratë e kuotave [gjinore],” “marrin pjesë sa për të votuar,” “të angazhuara sa për numër.” Këto etiketime janë përdorur nga burra dhe gra me përvojë në politikë. I nevrkosur me Dean, e cila kishte gjetur punë në një agjenci shtetërore – një mundësi që ai mendonte se e meritonte për vete – Agimi (Kolegu i Deas) u shpreh haptazi në një mbledhje partie: “Eh, si ka mundësi që këta të rinjtë po zënë këto lloj pozicionesh drejtuese?” Vajzat janë fyer gjatë seancave

parlamentare, mbledhjeve të partive dhe këshillave – me fyerje që përforconin bindjen se vajzat nuk janë të përgatitura dhe të afta për të qenë pjesë e politikës.

Burrat bënin shaka të pista për të nënvleftësuar gratë gjatë bisedave dhe për të objektivizuar seksualisht gratë. Besara, një ish-deputete tha se disa nga kolegët e saj burra në parlament bënin batuta gjatë bisedave. Për të, këto lloj batutash, krahas të qenit fyese dhe të sikletshme, nënkuptojnë për gratë që “ju nuk ja keni haberin, ju nuk dini asgjë, ju nuk merrni vesh nga politika.”

Gjuha poshtëruese në media, veçanërisht në mediat sociale

Gratë e cilësuan median si një burim të dhunës politike. Gratë e përfshira në politikë në nivel kombëtar ndanë me ne mendimin se media përjetëson një cikël dhune që përforcon hegjemoninë mashkullore. Gratë na treguan se janë etiketuar si “ku*va,” “shtriga,” “pula,” ndër etiketime të tjera.

Besara, një ish-ministre, tha se leximi i komenteve që njerëzit bëjnë për të në Facebook është “traumatik.” Besara i cilësoi komentet si “shumë të rënda.” Ajo tha: “Komente të tilla të ulin, të nënvlerësojnë dhe më vonë përdoren kundër teje.” Besara e ndjeu se po sulmohej më shpesh dhe më rëndë se sa kolegët e saj burra: “Jam plotësisht e bindur se gjuha e përdorur dhe komentet janë më të ashpra, shumë herë më denigruese, shumë më personale, shumë më ofenduese dhe poshtëruese [se sa ndaj burrave], dhe se gratë zakonisht sulmohen lidhur me ‘nderin’ e tyre dhe për faktin që janë gra.”

Gratë raportuan praktika të tjera të medias që përforcojnë ciklin e dhunës politike. Për shembull, publikimi i artikujve që fokusohet në “mënyrën se si vishen gratë në parlament,” rutinën e bukurisë së grave, peshën e tyre dhe balancën midis familjes dhe karrierës. Panelet e diskutimit që përbëhen vetëm nga burrat – ku ftohen vetëm burra të diskutojnë ngjarje politike ose të diskutojnë përvojat e grave dhe të flasnin në emër të tyre – përbën një tjetër praktikë që përforcon hegjemoninë mashkullore.

Akuzat e rreme në media

Gratë, veçanërisht ato në pozicione të nivelit të lartë (p.sh. ish-ministre, deputete, kryetare bashkie), ishin të shqetësuara rreth akuzave të rreme në media, veçanërisht në mediat sociale. Gentiana, një ish-ministre, i cilësoi këto akuza si “ofenduese,” “të shëmtuara,” “të deformuara,” dhe “skandaloze.” Ajo tha: “Gjëja më e shëmtuar gjatë fushatave zgjedhore është se njerëzit krijojnë llogari të rreme [në mediat sociale], nuk e zbulojnë identitetin e tyre, të ofendojnë dhe të denigrojnë.” Gentiana iu referua këtij grupi si “ushtarët e partisë,” duke treguar se ata janë caktuar nga partitë për të sulmuar kundërshtarët.

Akuzat e rreme ishin bërë kryesisht gjatë fushatave zgjedhore. Qëllimi i tyre ishte dobësimi i mbështetjes së grave në zgjedhje. Desara tregoi se disa ditë përpara ditës së zgjedhjeve, një gazetë publikoi një artikull, që theksonte se partia politike e Desarës kishte në plan të përdorte votat e saj për një kandidat tjetër. Ajo e cilësoi këtë gjë si sulm politik, që kërkonte të shkurajonte anëtarët e komunitetit të saj që të mos votonin për të.

Teksa përhapnin akuza të rreme në media, kundërshtarët përmendnin karakteristika të tilla si gjinia, mosha dhe besimi fetar. Një grua që kandidonte në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 tregoi historinë e saj, se si media e interpretoi si një akt korruptiv mënyrën e komunikimit me mbështetësit e saj dhe kërkimin e fondeve për kryerjen e fushatës. Artikujt në media përmendin bindjet dhe gjininë e saj: Ajo u shpreh se “Nëse i lexoni artikujt, do të shihni gjuhën denigruese të përdorur. Gruaja [emri i fshirë] që kërkon para haptazi.” Odeta një ish-nëpunëse shtetërore ka pasur një përvojë të ngjashme. Gjatë fushatës së fundit zgjedhore, një ndër kundërshtarët e saj – një zyrtar i nivelit të lartë – publikoi një status në Facebook, ku e akuzonte atë për korrupsion. Odeta tha: «Komentova menjëherë në statusin e tij dhe i thashë: Nxirr faktet dhe provat që jam e përfshirë në korrupsion.”

Kërcënimet

Disa vite më parë, Odeta kandidoi në zgjedhjet vendore. Dy ditë përpara ditës së zgjedhjeve, ajo mori një mesazh në llogarinë e saj të Facebook-ut. Ajo u shpreh se “Personi më thoshte që kam fotot dhe videot e tua, dhe nëse nuk tërhiqesh nga gara do t’i publikoj.” Por kërcënimet vinin edhe nga ana e partisë, veçanërisht nëse gratë nuk respektonin urdhrat e partisë. Kryetarët e partisë i vizitonin gratë në shtëpi për të diskutuar rreth axhendave të tyre, ose bisedonin me bashkëshortët apo baballarët e tyre. Nëse gratë nuk respektonin urdhrat e partisë ose nëse nuk heshtnin gjatë mbledhjeve, ato merrnin kërcënime. Gjatë një mbledhjeje të këshillit, Lediana kërkoi që bashkia të investonte në shërbimet publike në fshatin e saj. Disa ditë më vonë, një banor i fshatit i shkoi për vizitë në shtëpi dhe i tha që pse ndërhynte në çështjet e këshillit: “Ai po më bënte presion drejtpërsëdrejti, duke më pyetur se përse e ngrita atë problematikë. I thashë që ngrita një problem që na prek të gjithëve. Përse të mos marrim investime kur paguajmë taksa?”

Vënia në dyshim e aftësive të grave

Pasi u zgjodh kryetare këshilli, Aurorës i bënë një lumë pyetjesh dhe komentesh të tilla si “Pse more një përgjegjësi të tillë?” dhe “Nuk e ke idenë se çfarë përgjegjësie ke marrë mbi supe.” Ajo mori telefonata që “më kujtonin se mund të jepja dorëheqjen.” Këto mesazhe e bënë atë të dyshonte në aftësitë e saj, edhe pse ajo ishte një ndër personat më të kualifikuar në këshill. Eneida, një deputete, mori një kërkesë të veçantë nga votuesit e saj (burra): “Kam dëgjuar deklarata të tipit ne jemi zonë veriore [d.m.th., një zonë tradicionale] dhe do të donim një deputet burrë, ose, faleminderit që dëshironi të na përfaqësoni dhe që jeni aktive kudo, në media, por kemi nevojë për një deputet burrë.”

Aftësitë e grave janë vënë në dyshim për të nxitur paragjykimet gjinore, për të cenuar opinionin e votuesve – veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore – dhe për të dobësuar mbështetjen në zgjedhje. Kur Odeta ishte kandidate në zgjedhje, kundërshtarët e saj bënë një postim në një blog. Në postim viheshin

në dyshim aftësitë, kapacitetet dhe synimet e saj në politikë. Odeta tha: “Ata pyesnin se përse konkurron gjithmonë dhe shpërfillnin kontributin tim dhe të familjes sime në sferën politike.” Odeta mori fyerje edhe në Instagram: “Kam marrë mesazhe të tjera – kësaj radhe në Instagram – ku më kanë fyer, më kanë thënë që jam një turp dhe se nuk duhet të kandidoj.”

Heqja e grave nga listat e kandidatëve të partisë

Gratë që aspironin të ecnin përpara në karrierën e tyre politike thanë që kanë hasur vështirësinë e pakapërcyeshme të heqjes nga listat e kandidatëve të partisë. Për to, partia ku bënë pjesë ishte burimi kryesor i dhunës. Më poshtë do të ndajmë disa përvoja të Dafinës, Ermirës dhe Adelës, që i janë bashkuar dy partive politike kryesore të vendit në fillim të viteve 90-të.

Dafina kandidoi për kryetare bashkie. Ajo tha: “Isha një ndër kandidatet e para, më e preferuara, që garonte për kryetare bashkie [viti është fshirë]. Dhe le të themi që drejtuesit e nivelit të lartë të partisë më bënë presion që të hiqja dorë nga aspirata ime dhe t’i lija vendin tim një burri ... Sigurisht që kjo gjë më demoralizoi, pasi kam luftuar për këtë gjë dhe kandidati tjetër nuk është se ishte mbresëlënës ... ky ishte një moment ku u përballa haptazi me dhunën psikologjike.” Dafina pati një përvojë të ngjashme vite më vonë, kur iu kërkua që të hiqte dorë nga parlamenti.

Adela aspironte që të bëhej deputete. Ajo kishte një përvojë të gjatë në partinë e saj politike. Adela u bë pjesë e partisë në vitin 1993 dhe krenohet me aftësinë e saj për mobilizimin e anëtarëve të komunitetit gjatë fushatave zgjedhore. Pavarësisht rolit dhe kontributit të saj në parti, emri i saj “u zhduk” nga lista e partisë. Ja se si e përshkruan ajo përvojën e saj: “Është dhunë psikologjike kur garon dhe të përjashtojnë nga gara pa asnjë shpjegim... Unë isha kandidate në zgjedhjet e fundit parlamentare. Plotësova formularin e vetëdeklarimit, por më pas emri im u hoq nga lista. Kishim 20 emra nga komisioni [në Tiranë] – shumica nuk kishte fare lidhje me zonën. Komisioni që i zgjodhi e di më mirë këtë çështje”.

Ermira ndau dy përvoja. “Kur isha kandidate për listën e deputetëve, kalova fazën e parë. Ajo çfarë ndodhi ishte se në fazën e fundit, emri im u zhduk. Emri i dikujt tjetër hyri në listë – një person që nuk kishte asnjë lidhje me strukturat e partisë. Ai nuk ishte propozuar nga strukturat vendore të partisë dhe nuk kishte asnjë lidhje me degën vendore të partisë [emri është fshirë] ... Më pas erdhi Këshilli Kombëtar. Edhe pse isha ndër më të votuarat, nuk mu tha zyrtarisht se sa vota kisha marrë. Por, kisha njerëz brenda komisionit që më informuan. Fituesi ishte paracaktuar. Prandaj, brenda partisë nuk ka demokraci». Pas kësaj, Ermira dha dorëheqjen nga partia.

Dafina dhe Ermira theksuan se edhe pse burrat nuk janë imunë ndaj këtyre praktikave, ata janë më pak të cenueshëm krahasuar me gratë. Burrat kanë rrjete më të forta dhe lidhje më të ngushta me kryetarët e partive, ndaj kanë më shumë gjasa që t’ia dalin me sukses kur kandidojnë. Ermira theksoi se burrat kërkojnë që të forcojnë pozitën e tyre brenda partisë duke kandiduar disa herë në zgjedhje, teksa presin që kontributi i grave në politikë të jetë i përkohshëm. Gratë kujtuan praktika të tjera, të tilla si dorëheqja me detyrim pas marrjes së pozicioneve drejtuese, për t’u zëvendësuar nga burrat.

Refuzimi i aksesit në financat e partisë gjatë fushatave zgjedhore

Dafina kujtoi përvojën e saj, kur kandidoi për kryetare bashkie: “Kur kandidova në zgjedhje [viti është fshirë], më thërritën në takim dhe më thanë që në rregull, do të jesh pjesë e listës por duhet të gjesh burimin e mbështetjes financiare.” E zhgënjyer, ajo tha: “Disa morën mbështetje, disa jo. Disa më shumë, disa më pak. Unë jam një ndër ata persona që nuk ka marrë asgjë.” Si një person i angazhuar rishtazi në politikë, Desara tha se nuk ka marrë mbështetje nga partia e saj në fushatën e fundit zgjedhore. Ajo shpjegoi se arsyeja përse nuk u konsiderua “një investim i sigurt” për kryesinë e partisë ishte se suksesi i saj zgjedhor nuk ishte i garantuar.

Shkarkimi ose kërcënimi për shkarkimin e grave (dhe anëtarëve të familjes së tyre) nga postet shtetërore

Në të kaluarën, Ermira ka qenë drejtoreshë shkollë. Por gjërat ndryshuan në vitin 2015 kur partia e saj humbi zgjedhjet. Pak kohë më pas, atë e transferuan në një zonë rurale. Në të njëjtin vit, Brikenës iu kërkua që të jepte dorëheqjen nga puna e saj në një institucion shtetëror. Brikena tha: “Edhe pse kisha përvojë në punë, dy diploma dhe nuk kisha marrë asnjë ankesë për aq kohë sa isha në krye të një institucioni publik, m’u kërkua që të jepja dorëheqjen. E dhashë.” Ajo shpjegoi se institucioni i saj ishte objekt auditimi çdo muaj për dy vite radhazi, diçka që ndikoi në shëndetin e saj fizik dhe mendor. Brikena nuk mundi ta përballonte më presionin dhe dha dorëheqjen.

Gratë që ishin anëtare të këshillave bashkiak dhe nëpunëse shtetërore thanë se votat në kundërshti me vullnetin e drejtuesve të partive mund t’u kushtonin atyre (dhe anëtarëve të familjes së tyre) punën – pra një rrezik shumë i madh për ta marrë përsipër. “Nëse një grua punon në një departament shtetëror,” tha Ardita, “nuk ka mundësi zgjedhjeje. Ajo duhet të mbrojë rrogën e saj. Nuk është se ka mundësi të tjera pune, sidomos në komunitetet e vogla.» Gra të tjera ndanë të njëjtin shqetësim.

Akuzat e rreme dhe thashethemet e natyrës seksuale

Prania e grave në kafene – dhe përgjithësisht në hapësira ku historikisht gratë kanë qenë të përjashtuara – vazhdon të mos pritet mirë në disa komunitete. Nëse gratë sfidojnë normat dhe praktikat kulturore, ndiqen nga thashetheme të natyrës seksuale dhe stigmatizohen.

Renata jetonte në një komunitet të vogël rural, ku nuk gjykohej e përshtatshme që gratë të uleshin nëpër kafene. Ajo tha: “Nuk përfundoi mirë për disa nga mikeshat e mija, të cilat kërkuan ta ndryshonin këtë gjë [uljen në kafene]. Përhapeshin thashetheme dhe u njollosej reputacioni ... Kjo është diçka tejet delikate. Duhet të tregosh shumë, po shumë kujdes.” Por ky shqetësim nuk përfshinte vetëm zonat rurale. Gratë në zonat urbane thanë se fotot ku po pinin

kafe me burra u përdorën nga media për të dëmtuar reputacionin e tyre, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore.

Në disa komunitete, konsiderohet e papërshtatshme që gratë të frekuentojnë mbledhjet e partive vetëm. Pritshmëria është që gratë të shoqërohen nga baballarët apo bashkëshortët e tyre. Përndryshe, do të stigmatizohen. Renata ishte pjesë e këshillit bashkiak dhe u stigmatizua për thyerjen e këtij rregulli të pashkruar: “Unë jetoj në një komunitet të vogël, në të cilin njerëzit njihen me njëri-tjetrin, dhe fakti që një grua del nga shtëpia për t’u marrë me politikë është diçka e vështirë për t’u pranuar nga anëtarët e komunitetit. Edhe pse në këshill kemi përfaqësim të barabartë gjinor [në numër], në mbledhjet e partisë vijnë vetëm dy gra. Ne paragjykohe mi dhe etiketohemi si ‘gra të këqija.’” Renata na tregoi që në komunitet u përhapën thashetheme, të cilat ndikuan në marrëdhënien me bashkëshortin e saj.

Thashethemet dhe akuzat e rreme të natyrës seksuale përhapen veçanërisht në media. Gentiana, një ish-ministre, na tregoi një histori se si një portal në internet publikoi një artikull të gjatë, ku ajo portretizohej si e dashura e kryetarit të partisë. Ajo e përshkroi përvojën si “shkatërruese.” Pasi shpjegoi se çfarë ndodhi, ajo tha: “E merrni me mend se ç’do të thotë kjo. Je bashkëshorte, nënë, gjyshe. Je në një moshë [heshtje] që ... mund të mendosh për çdo gjë përveç kësaj gjëje.”

Ngacmimi seksual

Në pothuajse të gjitha rastet, gratë thanë që nuk kanë përjetuar abuzim apo ngacmim seksual. Ato ndiheshin më komode me ndarjen e historive të grave të tjera. Gratë na treguan që është e zakonshme që gratë të japin dorëheqje nga politika ose nga pozicione drejtuese për shkak të ngacmimeve seksuale. Përgjithësisht, këto raste nuk denoncohen për shkak të stigmës që mbartin. Gratë janë të shqetësuara se do të jenë të stigmatizuara përgjatë gjithë jetës, se nuk do të gjejnë drejtësi dhe se do të humbasin mundësitë për punësim.

Praktika të tjera përjashtuese

Praktikat e tjera përjashtuese përfshinin injorimin e grave gjatë takimeve, konsiderimin e kontributit të grave si pak ose aspak të rëndësishëm, kufizimin e rolit të grave në votimin e vendimeve të paracaktuara, manipulimin e votës së grave gjatë procedurave të votimit dhe përjashtimin e grave nga informacioni. Praktikat e tilla synonin që të mënjanonin gratë dhe t'i bënin ato të padukshme në politikë.

Dea, një këshilltare, ishte e shqetësuar se diskutimet e grave gjatë takimeve të këshillit bashkiak nuk merreshin seriozisht. Ajo tha: “Ka pasur raste kur, për shembull, një grua ka marrë fjalën për të diskutuar një problem dhe nuk është se ka ngjallur interes, të paktën jo aq sa kur një burrë merr fjalën për të diskutuar një problem ... Dua të them, e kam vënë re, se deri në njëfarë pike gratë injorohen ose nuk respektohen kur u japin zë problemeve të tyre. Fjalimet e grave nuk dëgjohen.” Grave nga komunitetet më pak të zhvilluara, si p.sh. në komunitetet në vende të thella në zona rurale, u është mohuar e drejta për të marrë fjalën – një praktikë diskriminuese, të cilën Dea u përpoq ta ndryshonte në këshillin e saj: “Ajo [një këshilltare nga një zonë e thellë rurale] po përpiquej të merrte fjalën, por kryetari i këshillit dhe zëvendëskryetari i këshillit po e injoronin atë. Nuk po e lejonin që të fliste. Unë, bashkë me një kolegen time, ndërhyëm sepse vumë re që ajo dëshironte të fliste lidhur me problemet që po diskutoheshin.” Kjo ishte hera e parë që ajo mori fjalën në dy vite.

Një tjetër praktikë përjashtuese ishte kufizimi i rolit të grave në votimin e vendimeve të paracaktuara. Lediana, një këshilltare, ndau me ne përvojën e saj: “Ata [nëpunësit bashkiakë] kishin vendosur ndërkohë se çfarë dëshironin të bënin dhe më pas erdhën dhe na kërkuan firmat tona, për miratim. Kur refuzuam, ata e morën personale. Ata nisën të na ofendonin. Nga njëra anë thanë se jemi këtu për të marrë miratimin tuaj, nga ana tjetër po na thonin që askujt nuk i intereson për ju.»

Një tjetër praktikë ishte manipulimi i votës së grave gjatë procedurave të votimit. Përvoja e Ermirës shërben si ilustrim i kësaj praktike: “Tri vite më parë, kur mbajtëm zgjedhjet për kryetarin, unë isha candidate. Por unë nuk e dija që isha candidate. Dy orë përpara konferencës, mora një telefonatë dhe më thanë: [Emri është hequr] jeni candidate dhe duhet të paraqiteni në [konferencë]. E pyeta si mund të bëjnë të tilla veprime. I

thashë se duhet të kem njerëzit e mi në komision dhe se duhet të ndjek procedurat. Ai u përgjigj: “Jo. Është vendosur se kush do të jetë kryetari. Ti do të jesh thjesht kukull. I thashë se nuk e pranoja këtë lloj situatë. Unë nuk jam kukull. Kushdo që mendon se mund të jem kukull, e ka gabim... Gara ishte fallco. Nuk kishte garë.”

Gratë që kundërshtuan këto praktika thanë se janë penalizuar – janë përjashtuar nga marrja e informacioneve. Pasi kundërshtoi kryetarin e bashkisë dhe disa nga anëtarët e partisë, Blertës nuk i dërgonin informacione lidhur me mbledhjet dhe aktivitetet e partisë. E zhgënjyer, Blerta tha: “Ata po përpiqen të më heqin qafe.”

ARSYET E DHUNËS POLITIKE

Autorët e dhunës kërkonin që të ruanin ose zgjeronin përfitimet e lidhura me postet politike, të tilla si vendet e punës, të ardhurat, pasuritë dhe qasjen në rrjete. Për shembull, akuzat dhe lajmet e rreme u përdorën më vrullshëm gjatë fushatave zgjedhore për të dobësuar mbështetjen e grave në zgjedhje. Publikimi i posteve në blogje që vinin në dyshim aftësitë, kapacitetet dhe synimet e grave në politikë u bë për të nxitur paragjykimet gjinore dhe për të ndikuar te votuesit. Praktika të tjera, si p.sh. kufizimi i rolit të grave në votimin e vendimeve të paracaktuara, janë përdorur për të kontrolluar gratë dhe për të bërë të padukshme në politikë. Kërkesat e votuesve për përfaqësues burra u bënë për të garantuar aksesin në rrjetet politike. Eneida i shpjegoi kërkesat e votuesve (burra) për përfaqësues (burra) në këtë mënyrë: “Ata [votuesit burra] kanë nevojë për përfaqësues burra, jo se do të përfaqësojnë më mirë, por sepse do të ulen së bashku, të pinë, tymosin duhan, të pinë raki, birra dhe të diskutojnë gjëra që nuk do të mund të diskutonin me mua.” Ky lloj aksesit në vendimmarrjen politike ndërpritet kur përfaqësohen nga një grua. Gratë e angazhuara rishtazi në politikë ndjenin që shiheshin si kërcënim nga burrat dhe gratë që kishin përvojë në sferën politike. Ato e kuptonin se nuk ishin të mirëpritura kur u drejtoheshin pyetje si “Ku ke qenë deri më tani [përpara se të përfshiheshe në politikë]?” “Si u bërë pjesë e politikës?” “Çfarë ke bërë për ta merituar këtë pozicion?”.

Në rastin e grave – veçanërisht të grave të cilat janë përpjekur të arrijnë pozicione drejtuese në parti – burimi kryesor i dhunës politike ka qenë vetë partia ku ato aderojnë. Gratë e cilësuan dhunën me të cilën janë përballur në partinë e tyre si “të fshehtë, të ndërlikuar dhe të vështirë për t’u trajtuar.” Dafina, një kryetare bashkie, e krahasoi luftën brenda dhe jashtë partisë, në këtë mënyrë: “Lufta brenda llojit është më e vështirë se sa ajo jashtë partisë. Lufta jashtë partisë është frontale, armiku është përballë, e di kë ke kundërshtar dhe mund të vëzhgosh strategjitë që ai përdor. Sigurisht, që përgatitesh për t’u përballur me të, dhe je e vetëdijshme për këtë gjë. Ndërkohë, në rastin e luftës brenda partisë, ti nuk e di kë ke armik, kush po përpiket të të dëmtojë – nuk arrin ta kuptosh menjëherë këtë gjë, sepse gradualisht sigurisht që kuptohet se kush nuk ka qëllime të mira, kush po përpiket të të vërë shkopinjë nën rrota, kush dëshiron mos të të shohë në pozicionin që je.” Një tjetër dallim është se sulmet politike janë më të zakonshme brenda partisë, veçanërisht nëse gratë aspirojnë të arrijnë pozicione drejtuese. Ermira u përpoq, në mënyrë të pasuksesshme, të kandidonte për Këshillin Kombëtar dhe në zgjedhjet parlamentare. Ajo tha: “Problemi më i madh është brenda partisë, sepse kundërshtarët ta thonë në sy që unë kam pushtet, mund të dëmtoj punën tënde, biznesin tënd – për ata që kanë një biznes në pronësi. Ndërkohë, brenda partisë, sulmet janë më të shpeshta, sidomos nëse të konsiderojnë si rivale për pozicione të rëndësishme.”

NDIKIMI I DHUNËS POLITIKE

Gratë, veçanërisht ato të angazhuara rishtazi, thanë se e kishin vënë në dyshim aftësinë dhe vendin e tyre në politikë. Pasi kryetari i këshillit e quajti “budallaqë”, Blerta tha se i kishte bërë pyetje vetes nëse kishte bërë diçka të gabuar. Pasi e bombarduan me pyetje nëse mund ta drejtonte këshillin, Aurora filloi të dyshonte nëse ishte mjaftueshëm e kualifikuar. “Por,” u shpreh ajo, “pashë përreth [këshillit] dhe dola në përfundimin se isha një ndër personat më të kualifikuar.” Gratë që kanë qenë objekt i akuzave të rreme dhe thashethemeve në media raportuan se këto përvoja kanë përkeqësuar problemet e tyre shëndetësore dhe u kanë shkaktuar probleme me gjumin. Akuzat e rreme dhe thashethemet me natyrë seksuale kanë patur pasoja traumatike për gratë dhe familjet e tyre – fëmijët, prindërit dhe partnerët.

Dafina na tregoi në mirëbesim se “Ajo që ndodhi në atë periudhë [kur u përhapën lajme të rreme me natyrë seksuale] ishte tejet e vështirë. Kjo është një formë [dhune] që dhe të tjerë mund ta kenë përjetuar, nuk është e drejtpërdrejtë, por pa dyshim që është abuzive në maksimum ... Këto praktika nuk janë të drejta dhe të shkaktojnë trauma [qan].” Gentiana, që u akuzua në mënyrë të padrejtë si e dashura e kryetarit të partisë, tha se është ndjerë e turpëruar për diçka që nuk e kishte bërë dhe se ishte shumë e sikletshme për të që të përballej me studentët në klasë. Ajo tha që “Disa të vërteta nuk mund të shtrembërohen dhe se kjo fyerje është tejet e rëndë.”

Akuzat e rreme dhe thashethemet e natyrës seksuale kanë ndikuar dhe në marrëdhëniet e grave me partnerët e tyre. Renata jetonte në një komunitet të vogël dhe ishte një ndër të paktat gra që frekuentonte mbledhjet e partisë. Një ditë, bashkëshorti i saj erdhi në shtëpi dhe i tha që një mik i tij e kishte pyetur “Përse shkon bashkëshortja jote atje [në mbledhjet e partisë]? Për kë shkon atje?” Renata kërkoi ndihmën e vjehrrit dhe të vjehrrës së saj për të adresuar situatën.

Gra të tjera, që kanë dhënë dorëheqjen nga partia, thanë se e kanë marrë këtë vendim pas disa përpjekjeve të pasuksesshme për të ngjitur shkallët në politikë. Gjatë karrierës së saj politike, që nisi në fillim të viteve 90-të, Ermira aspironte që të bëhej deputete. Ajo haste vazhdimisht të njëjtën pengesë: Ajo propozohej nga strukturat vendore të partisë, por emri i saj zhdukej nga lista e kandidatëve të partisë. Ajo e ndjeu që ishte rrugë pa krye dhe u zhgënjye, e kësisoj dha dorëheqjen nga partia.

Disa gra u tërhoqën nga politika pasi u angazhuan për një periudhë të shkurtër. Aurora – përfaqësuese e shoqërisë civile – drejtoi këshillin bashkiak për një mandat të vetëm, duke shpresuar, ndër të tjera, që të përmirësonte jetën e personave me aftësi të kufizuara – duke zgjeruar shërbimet sociale dhe duke i bërë rrugët më të aksesueshme. Ajo dha dorëheqjen pas mandatit të parë. Aurora tha se drejtuesit politikë nuk e mbështetën, rrjetet politike nuk mund të aksesoheshin dhe, edhe pse ishte një zë i fuqishëm për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, zëri i saj nuk dëgjohej.

PERSPEKTIVA TË TJERA LIDHUR ME DHUNËN NDAJ GRAVE NË POLITIKË (DISKUTIME NË GRUP)

Gazetarët, Rrjeti “Barazi në Vendimmarrje”, organizatat e shoqërisë civile, forumet rinore,

Aleanca e Grave Këshilltare, drejtueset gra të njësive administrative

Aktorë të tjerë dhanë informacione shtesë lidhur me dhunën ndaj grave në politikë.

Gazetarët:

- Gazetarët kryesisht raportojnë rastet e dhunës fizike, dhe raste të tilla zakonisht ndodhin gjatë protestave dhe fushatave zgjedhore.
- Politika ndikon në mënyrën se si dhuna politike portretizohet në media – llojin e mesazheve që i përcillen audiencës dhe mënyrën se si përcillen ato.
- Fyerjet, sharjet dhe ofendimet konsiderohen “normale” në mjediset zyrtare. Prandaj, nuk denoncohen.
- Kërcënimet janë të zakonshme gjatë fushatave zgjedhore. Shpeshherë, kërcënimet mbahen sekret dhe nuk bëhen publike.
- Artikujt e gazetave kanë tendencën të fokusohen në jetën private të grave dhe në paraqitjen e tyre fizike – jo në rolin e tyre në politikë.
- Rastet e dhunës brenda partive kanë tendencën të mos bëhen publike.

Rrjeti “Barazi në Vendimmarrje”:

- Gratë përballen me dhunë psikologjike, kërcënime për shkarkim nga puna dhe gjoba, dhe atyre u mohohet akses në fonde gjatë fushatave zgjedhore. Thashethemet me natyrë seksuale kanë në shënjestër kryesisht gratë.
- Dhuna brenda partive është më e shpeshtë dhe më e rëndë sesa ajo midis partive. Dhuna politike brenda partisë është “e padukshme, e fshehtë, tinëzare.”
- Partia është burimi kryesor i dhunës. Drejtuesit e partive zgjedhin të preferuarit e tyre – persona jo gjithmonë të kualifikuar ose të cilët nuk kanë lidhje të forta me komunitetin – injorojnë opinionet e anëtarëve të partisë, heqin nga listat e kandidatëve partiakë anëtarë të partisë me kontribut të rëndësishëm, paracaktajnë rezultatet zgjedhore, bëjnë shpërndarje të padrejtë të burimeve (p.sh. të fondeve gjatë fushatave zgjedhore) dhe nuk janë transparentë gjatë vendimmarrjes. *Një sistem i centralizuar dhe i padrejtë vendimmarrjeje brenda partive sjell dhunë, dhe e përdor dhunën si kërcënime dhe akuza për të mbijetuar.*

Organizatat e shoqërisë civile:

- Programet e trajnimit janë fokusuar në përgatitjen e grave për të marrë pjesë në politikë – në rritjen e vetëvlerësimit dhe në komunikimin me votuesit. Deri më tani, programet e trajnimit nuk janë fokusuar në dhunën politike.
- Organizatat e grave – politike ose jo – nuk janë fokusuar në atë çfarë ndodh brenda partive politike dhe në dhunën që përjetojnë gratë.
- Gratë që angazhohen në politikë – veçanërisht në komunitetet të vogla, tradicionale – përballen me akuzat të rreme dhe thashetheme me natyrë seksuale.
- Lufta brenda partive politike është e fshehtë.
- Shpeshherë, organizohen mbledhje dhe fushata zgjedhore vetëm me anëtarët burra të partisë. Këto lloj aktivitetesh përforcojnë paragjykimet gjinore dhe përjashtimin e grave nga politika.
- Kryetarët e partive përdorin kuotat gjinore për të promovuar axhendat e tyre private – jo publike.
- Gratë janë të shqetësuara se nëse e denoncojnë dhunën, ato do të etiketohen si viktime dhe do të stigmatizohen brenda partive përkatëse.
- Anëtarët e shoqërisë civile duhet të kandidojnë në zgjedhje. Mund të jetë e vështirë për politikanet të sjellin ndryshim nëse nuk janë anëtarë partie; megjithatë, prezenca e tyre në politikë do të rrisë cilësinë e përfaqësimit.

Forumet rinore:

- Kryetarët e partive bëjnë sikur i mbështesin gratë në syrin e publikut por i kërcënojnë dhe i diskriminojnë ato pas dyerve të mbyllura. Një vajzë u shpreh: “Sa më shumë të shihni përpjekje për fuqizimin e grave [në syrin e publikut], aq më shumë dhunë ekziston në prapaskenë.”
- Diskutimet brenda partive politike janë fokusuar në promovimin e sa më shumë grave në politikë dhe jo në dhunën që përjetojnë gratë. Dhuna politike shpeshherë diskutohet në kafene.
- Drejtueset gra dhe anëtarët e forumeve rinore thanë se janë ndjerë të paragjykuara nga anëtarët e komunitetit për përfshirjen në politikë. Disa nga bindjet janë se gratë janë të paaftha, të paarsimuar, nuk mund të merren me politikë dhe nuk meritojnë që të jenë pjesë e politikës.
- Dhuna politike – veçanërisht dhuna psikologjike dhe seksuale – është një ndër arsyt përse vajzat nuk bëhen pjesë e politikës.

Aleanca e Grave Këshilltare:

- Përmes përpjekjeve të përbashkëta, këshilltaret bashkiake kanë ndër marrë nisma për të mbështetur grupe në nevojë, si p.sh. viktimat e dhunës në familje, kryefamiljaret, dhe kanë organizuar fushata për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me dhunën në familje. Sidoqoftë, këto nisma nuk janë fokusuar në dhunën politike.
- Edhe pse numri i grave në këshillat bashkiak është rritur, burrat janë ata të cilët mbajnë pozicione drejtuese. Në disa komunitete, numri i grave në pozicione drejtuese mbetet i papërfillshëm.
- Ka mungesë ndërgjegjësimi lidhur me dhunën politike.
- Diskutimi i pengesave që hasin gratë në politikë – duke përfshirë dhunën – dhe i mënyrave se si gratë mund të trajtojnë këto pengesa, mund të japin shtysë vazhuese që të marrin pjesë në politikë.

Gratë në krye të njësive administrative:

- *Është e zakonshme* të hasësh banorë që janë skeptikë ndaj aftësive të grave për të drejtuar njësiti administrative. Kryetarja e një njësie administrative ndau përvojën e saj: “Shumica [e anëtarëve të komunitetit] nuk mund ta kapërdijnë idenë që një grua të zgjidhë problemet e tyre, ose që mund të diskutojnë problemet e tyre me një grua. Ata dërgojnë shumë kërkesa apo ankesa direkt në bashki, sepse mendojnë që një grua nuk do të arrijë të ndihmojë.”
- Disa anëtarë të komunitetit janë përpjekur që të ndikojnë te gratë përmes të afërmeve të tyre të gjinisë mashkullore. Gratë nuk janë ndjerë mirë nga këto kërkesa dhe thanë se kërkesat kanë ndikuar në marrëdhëniet e tyre me anëtarët e familjes.

GJETJET: KOMPONENTI SASIOR

Tri fushat e politikave për të cilat kandidatët politikë flasin ose shkruajnë më së shumti në publik përfshijnë arsimin (52,29%), papunësinë dhe krijimin e vendeve të punës (41,18%), si dhe shëndetësinë (31,37%). Burrat kishin më shumë gjasa të raportonin se ata flasin ose shkruajnë rreth infrastrukturës dhe transportit, bujqësisë, sigurisë publike dhe zhvillimit të bizneseve. Gratë kishin më shumë gjasa të raportonin se ato flasin ose shkruajnë rreth barazisë

gjinore dhe të drejtave të grave, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve dhe mirëqenies sociale. Për të përcjellë mesazhet e tyre, kandidatët politikë kanë përdorur kryesisht mediat sociale dhe digjitale (76,14%), takimet derë më derë (63,73%), mitingjet dhe takimet me grupe banorësh (50,98%), si dhe posterat dhe fletushkat (34,64%). Burrat (70,78%) kishin më shumë gjasa se gratë (56,58%) të raportonin që ata përdorin vizitat derë më derë për të përcjellë mesazhet e tyre politike.

KLIMA POLITIKE

Kandidatët politikë u pyetën nëse *frikësimi (intimidimi) dhe dhuna, gjuha poshtëruese dhe lajmet e rreme, kërcënimet, dhuna fizike dhe dëmtimi i pronës janë një pjesë normale e politikës në vend. Një përqindje më e lartë e kandidatëve politikë thanë se gjuha poshtëruese dhe lajmet e rreme (55,56%) janë pjesë normale e politikës, pasuar nga frikësimi dhe dhuna (42,16%), kërcënimet ndaj politikanëve (30,16%), dëmtimi i pronës (16,34%) dhe dhuna fizike (6,86%). Më poshtë gjendet më shumë informacion.*




Figura 1:
“Dhuna është pjesë normale e politikës”

42,16% e të anketuarve (n = 129) u shprehën se frikësimi dhe dhuna janë një pjesë normale e politikës në vend, 36,60% (n = 112) thanë se “ndodhin ndonjëherë,” dhe 21,24% (n = 65) thanë se “nuk janë pjesë normale e politikës.”




Figura 2:

A do të thonit se frikësimi dhe dhuna janë pjesë normale e politikës në vend?

55,56% e të anketuarve (n = 170) thanë se *gjuha poshtëruese dhe lajmet e rreme* rreth politikanëve janë pjesë e politikës, 32,68% (n = 100) thanë se “ndodhin ndonjëherë”, dhe 11,76% (n = 36) thanë se “nuk janë pjesë normale e politikës.”




Figura 3:

A janë gjuha poshtëruese dhe lajmet e rreme rreth politikanëve një pjesë normale e politikës në vend?

30,16% e të anketuarve (n = 92) thanë se *kërcënimet* ndaj politikanëve janë pjesë e politikës, 42,30% (n = 129) thanë se “ndodhin ndonjëherë”, dhe 27,54% (n = 84) thanë se “nuk janë pjesë normale e politikës.”




Figura 4:

A janë kërcënimet ndaj politikanëve një pjesë normale e politikës në vend?
 6,86% e të anketuarve (n = 21) thanë se *dhuna fizike* ndaj politikanëve është pjesë e politikës, 44,77% (n = 137) thanë se “ndodh ndonjëherë,” dhe 48,37% (n = 148) thanë se “nuk është pjesë normale e politikës.”




Figura 5:

A është dhuna fizike ndaj politikanëve një pjesë normale e politikës në vend?
 16,34% e të anketuarve (n = 50) thanë se *dëmtimi i pronës* – personale ose të partisë – është pjesë e politikës, 46,41% (n = 142) thanë se “ndodh ndonjëherë,” dhe 37,25% (n = 114) thanë se “nuk është pjesë normale e politikës.”




Figura 6:

A është dëmtimi i pronës – personale ose të partisë – një pjesë normale e politikës në vend?

Nuk pati dallime statistikisht të konsiderueshme ndërmjet grave dhe burrave mbi mënyrën se si ata e vlerësonin klimën politike në vend. Përvoja gjatë fushatës zgjedhore dhe mandateve parlamentare

Gjuha poshtëruese ose lajmet e rreme

31,05% e të anketuarve (n = 95) raportuan se kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme* në rolin e tyre si politikan/e.




Figura 7:

A keni përjetuar gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme në rolin tuaj si politikan/e?

Nga të anketuarit që raportuan se kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme* 45 ishin gra (29,61%) dhe 50 ishin burra (32,47%). Kandidatët politikë ishin shënjestruar kryesisht nga mbështetësit e partive të tjera (57,45%), nga media digjitale dhe sociale (50%) dhe drejtuesit e partive të tjera (44,68%). Një përqindje më e lartë e burrave (56,00%, n = 28) sesa e grave (31,82%, n = 14) raportuan se kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme* nga drejtuesit e partive të tjera. *Gjuha poshtëruese ose lajme e rreme* ndodhën kryesisht në publik (70,22%), pasuar në aktivitetet politike (36,17%) dhe në mjediset private (29,03%). Kandidatët politikë kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme* kryesisht gjatë fushatës (87,23%). *Gjuha poshtëruese ose lajmet e rreme* shënjestronin kryesisht gjininë (23,40%), moshën (21,28%), statusin social (21,28%) dhe statusin ekonomik (17,02%). 21 nga 22 të anketuar që thanë se kanë qenë objekt i *gjuhës poshtëruese ose lajmeve të rreme* për shkak të gjinisë ishin gra; 13 nga 20 të anketuar që kanë qenë objekt i *gjuhës poshtëruese ose lajmeve të rreme* për shkak të moshës ishin gra. Ndër personat që raportuan se kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme* në rolin e tyre si politikan/e, 15,96% thanë se e kanë përjetuar një herë, 41,49% thanë se e kanë përjetuar pak herë, 34,04% thanë disa herë dhe 8,51% thanë shumë herë.




Figura 8:

Sa shpesh keni përjetuar gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme?

Mesatarisht, kandidatët politikë janë përballur me 6,03 raste (DS = 7,55) të *gjuhës poshtëruese ose lajmeve të rreme*. Numri mesatar i herëve që gratë kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme* (M = 6,64, DS = 10,02) ishte më i lartë se i burrave (M = 5,45, DS = 4,17). Sidoqoftë, diferenca nuk ishte statistikisht e konsiderueshme. Njëzet e tre kandidatët politikë (24,47%)

raportuan se *gjuha poshtëruese ose lajmet e rreme* kishin natyrë seksuale. Përqindja e grave që thanë se gjuha poshtëruese ose lajmet e rreme me të cilat ishin përballur kishin natyrë seksuale, ishte më e lartë në krahasim me burrat. 43,18% e grave të anketuara që kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme* (n = 19) thanë se kjo lloj dhune kishte natyrë seksuale. Në rastin e burrave, vetëm 8% e tyre raportuan të njëjtën gjë (n = 4). Për sa i përket pritshmërive, më shumë se gjysma e të anketuarve (51,06%) që kanë përjetuar *gjuhë poshtëruese ose lajme të rreme* thanë se kishin përjetuar më shumë nga çfarë kishin parashikuar, 15,96% kishin përjetuar më pak nga çfarë kishin parashikuar dhe 32,98% kishin përjetuar aq sa kishin parashikuar.

Kërcënimet ndaj politikanëve

13,40% e të anketuarve (n = 41) raportuan se kanë marrë kërcënime në lidhje me rolin e tyre në politikë.




Figura 9:

A kenë përjetuar kërcënime në lidhje me pozicionin tuaj në politikë?

23 të anketuar që raportuan se kanë përjetuar *kërcënime* ishin burra (14,94%) dhe 18 ishin gra (11,84%). Kandidatët politikë ishin shënjestruar kryesisht nga drejtuesit e partive të tjera (60,98%) dhe nga mbështetësit e partive të tjera (58,54%). Burime të tjera përfshijnë deputetët nga partitë e tjera (21,95%) dhe nëpunësit shtetërorë (21,95%). *Kërcënimet* ndodhën kryesisht në mjedise private (43,90%)

dhe gjatë aktiviteteve politike (34,15%). Pjesa më e madhe e personave që kanë përjetuar *kërcënime* (90,24%) thanë se *kërcënimet* janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. 17,07% e atyre që raportuan se kanë përjetuar *kërcënime* (n=7) thanë se i kanë përjetuar një herë, 34,15% thanë pak herë (n = 14), 36,59% thanë disa herë (n = 15) dhe 12,20% thanë shumë herë (n = 5). Gjashtë të anketuar thanë se kërcënimet kishin natyrë seksuale.




Figura 10:

Sa shpesh keni përjetuar kërcënime?

58,54% e atyre që kanë përjetuar kërcënime thanë se ata kishin përjetuar më shumë nga çfarë kishin parashikuar (n = 24), 12,20% thanë se kishin përjetuar më pak nga çfarë kishin parashikuar (n = 5) dhe 29,27% thanë se kishin përjetuar aq sa kishin parashikuar (n = 12). 5,56% e të anketuarve (n = 17; 6 gra dhe 11 burra) thanë se kanë përjetuar kërcënime ose ngacmime në mënyrë të vazhdueshme nga i njëjti person (d.m.th., kërcënimi ose ngacmimi ka zgjatur për disa javë apo disa muaj).




Figura 11:

A keni përjetuar kërcënim ose ngacmim në mënyrë të vazhdueshme nga i njëjti person? Dhuna fizike

Gjashtë të anketuar (1,96%; 4 gra dhe 2 burra) raportuan se kanë përjetuar dhunë fizike në lidhje me rolin e tyre në politikë.




Figura 12:

A keni përjetuar dhunë fizike në lidhje me rolin tuaj në politikë?

Kandidatët politikë ishin në shënjestër të anëtarëve të komunitetit, drejtuesve të partive të tjera, deputetëve të partive të tjera, grupeve militante të organizuara, pjesëtarëve të ushtrisë dhe oficerëve të policisë. Dhuna fizike ka ndodhur në një sërë mjedisesh – publike dhe private. Katër nga 6 të anketuar që kishin përjetuar *dhunë fizike* u shprehën se dhuna kishte ndodhur gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Të 6 të anketuarit thanë se kishin pritur më pak *dhunë fizike* seç kishin përjetuar.

Dëmtimi i pronës

10,16% e të anketuarve (n = 31; 12 gra dhe 19 burra) thanë se u është *dëmtuar prona* gjatë përfshirjes së tyre në politikë.




Figura 13:

A ju është dëmtuar prona gjatë përfshirjes tuaj në politikë?

Kandidatët politikë kanë qenë në shënjestër të anëtarëve të komunitetit (n = 3), të mbështetësve të së njëjtës parti (n = 1), drejtuesve të partive të tjera (n = 7), deputetëve të partive të tjera (n = 1), mbështetësve të partive të tjera (n = 20), grupeve të organizuara militantësh (n = 3), punonjësve të policisë (n = 3) dhe të zyrtarëve të qeverisë (n = 1). Dëmtimi ka ndodhur kryesisht gjatë periudhës së fushatës zgjedhore (n = 28). Ndër personave që u është dëmtuar prona, 12 thanë se e kanë përjetuar dëmtimin një herë, 9 thanë pak herë, 8 thanë disa herë dhe 1 tha shumë herë.




Figura 14:
Sa shpesh ju është dëmtuar prona?

51,61% e të anketuarve që u është shkaktuar dëmtim i pronës (n = 16) thanë se kishin pritur më pak dëmtime të pronës nga sa kishin përjetuar, 25,81% (n = 8) thanë se kishin pritur më shumë dëmtime të pronës nga sa kishin përjetuar dhe 22,58% (n = 7) thanë se kishin përjetuar aq sa kishin parashikuar.

Llojet e tjera të dhunës

18,52% e të anketuarve (n = 55; 31 gra dhe 24 burra) thanë se atyre u është mohuar mbështetja financiare nga partia, 12,79% (n = 39; 25 gra dhe 14 burra) thanë se kanë marrë kërcënime për largimin nga puna për shkak të përfshirjes në politikë dhe 6,89% (n = 21; 9 gra dhe 12 burra) thanë se kanë marrë kërcënime nga anëtarët e familjes – kërcënime për shkëputjen nga burimet ekonomike apo pronat – për shkak të përfshirjes në politikë.




Figura 15:

Llojet e tjera të dhunës të përjetuara nga kandidatët politikë

Dhuna ndaj personave që janë të afërt me kandidatët politikë 12,42% e të anketuarve (n = 38; 20 gra dhe 18 burra) thanë se personat e afërt me ta kanë përjetuar dhunë (p.sh., gjuhë poshtëruese, lajme të rreme, kërcënime, dhunë fizike, dëmtim të pronës) për shkak të tyre politik.




Figura 16:

A ka përjetuar dhunë ndonjë nga personat që janë të afërt me ju për shkak të rolit tuaj politik?

Viktimat e dhunës ishin kryesisht anëtarët e familjes (67,57%), miqtë (35,14%) dhe njerëzit që punojnë për kandidatët politikë (32,43%). Kjo lloj dhune ka ndodhur kryesisht gjatë periudhës së fushatës zgjedhore (n = 33). 13,16% e të anketuarve (n = 5) që thanë se personat e afërt me ta kanë përjetuar dhunë raportuan se dhuna ka ndodhur vetëm një herë, 36,84% (n = 14) thanë pak herë, 34,21% (n = 13) thanë disa herë dhe 15,79% (n = 6) thanë shumë herë.




Figura 17:

Sa herë mendoni se personat që janë të afërt me ju kanë përjetuar dhunë politike? Për sa i përket pritshmërive, 62,16% e të anketuarve që thanë se personat e afërt me ta kanë përjetuar dhunë (n = 23) u shprehën se kishin pritur më pak dhunë, 8,11% (n = 3) u shprehën se kishin pritur më shumë dhunë dhe 29,73% (n = 11) u shprehën se kishin pritur aq sa kishin përjetuar.

Trajtimi i dhunës

Kandidatët politikë u pyetën nëse partia e tyre disponon një Kod Sjelljeje ose instrument tjetër që parashikon dhunën ndaj grave ose dhunën me bazë gjinore. 57,52% e të anketuarve thanë se partia e tyre disponon një Kod Sjelljeje ose instrument tjetër, 10,46% thanë se partia e tyre nuk disponon një Kod Sjelljeje ose instrument tjetër dhe 32,03% thanë se nuk kanë dijeni.




Figura 18:

A ka partia juaj një Kod të Sjelljes apo instrumente të tjera që parashikojnë dhunën ndaj grave ose dhunën me bazë gjinore?

Kandidatët politikë u pyetën edhe nëse partia e tyre disponon mekanizma apo struktura të krijuara për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, me fokus te viktimia. 46,73% e të anketuarve thanë se partia e tyre disponon mekanizma dhe struktura, 16,01% thanë se partia e tyre nuk disponon një mekanizëm të tillë dhe 37,25% thanë se nuk kanë dijeni.




Figura 19:

A ka partia juaj mekanizma apo struktura të dedikuara që janë ngritur për të parandaluar dhe trajtuar çdo rast të dhunës me bazë gjinore, duke vënë në fokus te viktimën?

58 kandidatë politikë – 18,95% e të anketuarve ose 57,42% e personave që kishin përjetuar dhunë – thanë se i kishin ndarë përvojat e tyre me partinë. Strukturat kryesore me të cilat kandidatët politikë ndanë përvojat e tyre ishin drejtuesit e partive (68,42%) dhe koordinatorët politikë (52,63%). Arsyet përse kandidatët politikë nuk e ndanin përvojën e tyre me strukturat e partisë ishin se ata nuk mendonin që strukturat do të reagonin, kandidatët politikë e konsideronin dhunën si diçka personale ose nuk e konsideronin përvojën e tyre si mjaftueshëm shqetësuese. Përgjigjet më të zakonshme ishin: “Nuk besoja se do të merrnin masa për të më mbrojtur,” “Nuk i besoj askujt” dhe “E konsideroj si problem personal.”

36,84% e personave që ndanë përvojat e tyre me strukturat e partisë thanë se strukturat e partisë morën masa. Masa kryesore ishte një deklaratë shtypi dhe denoncimi i dhunës. Kandidatët politikë u shprehën se ata e mbështesin njëri-tjetrin në mediat sociale. Masa të tjera, më të rralla, përfshinin denoncimin e dhunës në polici dhe prokurori, denoncimin publik të dhunës në parlament dhe organizimin e mbledhjeve në parti për të diskutuar problemin.

Anëtarët e partive të vogla ishin kryesisht ata që i ndanë arsyet përse strukturat e partisë nuk morën asnjë masë. Ata thanë që partia e tyre ishte e pafuqishme, ose siç u përgjigj një prej të anketuarve “partia në pushtet ka të gjithë fuqinë.” Të anketuar të tjerë thanë se fushata zgjedhore ishte shumë intensive dhe ata nuk menduan se do të zgjidhnin gjë nëse do të komunikonin me strukturat e partisë, situata nuk u përkeqësua dhe ata e ndoqën çështjen vetë. Një i anketuar tha se ishte pikërisht partia e tij që e sulmoi.

57,14% e të anketuarve që ishin përballur me dhunë thanë se e kishin ndarë përvojën e tyre me aktorë të tjerë, krahas strukturave të partisë. Kandidatët politikë i ndanin përvojat e tyre kryesisht me familjen (80,70%) dhe me miqtë (78,95%). Burrat kishin më shumë gjasa që të ndanin përvojat me miqtë e tyre: 92,59% e burrave (n = 25) dhe 66,67% e grave (n = 20) që kanë përjetuar dhunë thanë se i kanë ndarë këto përvoja me miqtë e tyre. Një numër i vogël i të anketuarve thanë se kishin informuar Policinë e Shtetit (n = 5), Avokatin e Popullit (n = 1) dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (n = 2). 18,33% e aktorëve jo-politikë (n = 11) morën masa.

Arsyeja kryesore përse kandidatët politikë nuk e ndanë përvojën e tyre ishte se ata nuk besonin që aktorët jo-politikë do të merrnin ndonjë masë. Një arsye tjetër ishte se ata nuk

dëshironin që të shqetësonin anëtarët e familjes ose se ata u përpoqën të mbronin anëtarët e familjes duke mos i përfshirë. Një i anketuar tha se kishte frikë nga pasojat. Nëse rasti bëhej publik, ai do të vuante pasoja të tilla si shkarkimi nga puna. Disa nga shembujt e përgjigjeve ishin: “Nuk do të ndryshonte asgjë,” “Nuk njoh njerëz që mund të adresonin situatën time,” “Nëse nuk gjen mbështetje brenda partisë, nuk mund të gjej [mbështetje] jashtë saj.”

Familja u ofroi mbështetje emocionale dhe i nxiti kandidatët politikë të vazhdonin garën. Kandidatët politikë mobilizuan familjen dhe miqtë që të reagonin në mediat sociale. Një nga të anketuarit u shpreh: “Familja dhe miqtë më dhanë optimizëm, dhe u përpoqën të reagonin në rrjetet sociale dhe të mbështesnin imazhin tim publik.”

NDIKIMI I ANGAZHIMIT NË POLITIKË

Ndikimi i angazhimit në politikë u vlerësua në raport me reputacionin, ndjenjën e sigurisë, vetëvlerësimin, rikandidimin, krenarinë, frymëzimin e brezit të ri dhe diskutimin e çështjeve që ngjallin kundërshtime. Diskutimi i çështjeve që ngjallin kundërshtime (M = 8,56, DS = 2,06), krenaria (M = 8,40 DS = 2,13), vetëvlerësimi (M = 8,36, DS = 1,82), dhe frymëzimi i brezit të ri (M = 8,25, DS = 2,40) kishin vlerën më të lartë mesatare, në krahasim me ndjenjën e sigurisë (M = 7,19, DS = 2,43), reputacionin (M = 7,50, DS = 2,18) dhe rikandidimin (M = 7,67, DS = 3,05). Nuk pati diferenca statistikisht të konsiderueshme ndërmjet burrave dhe grave.

SUGJERIME

Gratë në politikë

Trajtimi i dhunës ndaj grave në politikë kërkon që para së gjithash partitë të demokratizohen. Nëse partitë demokratizohen, gratë do të përjetojnë më pak dhunë psikologjike. Përgjithësisht, klima politike do të jetë më pak agresive. Një sistem drejtësie më efikas dhe që reagon, do të rrisë besimin e grave në institucionet shtetërore dhe do t'i nxisë ato që të denoncojnë rastet e dhunës. Organizatat e grave, si p.sh. Aleanca e Grave Deputete, Aleanca e Grave Këshilltare dhe forumet politike, duhet të përqendrohen te dhuna me të cilën përballen gratë pas dyerve të mbyllura, të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, si dhe duhet të prezantojnë mekanizma dhe rregullore për trajtimin e dhunës politike. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

duhet të luajë një rol proaktiv për të parandaluar dhunën ekonomike (p.sh. shpërndarjen e pabarabartë të fondeve gjatë fushatave zgjedhore) dhe për të monitoruar partitë politike. Gratë sugjeruan miratimin dhe zbatimin e ligjeve që ndëshkojnë autorët e dhunës (duke përfshirë median), angazhimin e burrave në diskutimin e dhunës politike dhe zhvillimin e shërbimeve sociale për mbështetjen e viktimave të dhunës politike. Sugjerime të tjera përfshinin rritjen e ndërgjegjësimit rreth dhunës politike dhe përfshirjen e konceptit të dhunës politike në sistemin arsimor fillor.

Kandidatët politikë

Kandidatët politikë sugjeruan krijimin e mekanizmave dhe instrumenteve ligjore që ndëshkojnë autorët e dhunës – përpara, gjatë dhe pas zgjedhjeve. Sugjerime të tjera përfshinin mosangazhimin e administratës shtetërore në zgjedhje, depolitizimin e Policisë së Shtetit, organizimin e fushatave informuese për dhunën politike, diskutimin e dhunës politike në media, hartimin e programeve për dhunën dhe dhunën politike në programet e arsimit fillor dhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të Avokatit të Popullit gjatë fushatave zgjedhore – për të identifikuar dhe denoncuar rastet e dhunës politike. Kandidatët politikë bënë thirrje për më shumë koordinim ndërmjet institucioneve për të trajtuar dhunën politike.

Gazetarët

Gazetarët thanë se mediat (a) nuk duhet të publikojnë artikuj që përdorin gjuhën poshtëruese, që përforcojnë stereotipet gjinore apo që përjetësojnë dhunën dhe (b) në raste dhune, duhet të reagojnë nëpërmjet botimit të editorialeve. Gazetarët sugjeruan edhe ofrimin e seancave të trajnimit për shkrimin e artikujve profesionalë rreth dhunës. Për të mbështetur përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave në politikë, mediat duhet t'i kushtojnë vëmendje përbërjes së paneleve të diskutimit dhe të shmangin panelet që përbëhen vetëm nga burrat. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) duhet të ndërmarrë hapa për të garantuar që gratë të cilat kandidojnë për poste politike shfaqen në media dhe atyre u lejohet një minutazh i drejtë televiziv për t'u komunikuar votuesve mesazhin dhe agjendën e tyre politike.

